

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. SIMON PASHUKU

11/22/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 21.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Simon Pashuku, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 22.11.2019, vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Simon Pashuku, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Brunilda Bekteshi, znj. Xhensila Pine relatores, znj. Suela Zhegu anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.